



KOMUNA E MITROVICËS JUGORE
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

DATË/A:	10.07.2025
REFERENC-Ë:	642-25-3767-2-1-1
PËR/ZA/TO:	Operatori Ekonomik: “BENI - COM SH.P.K”
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Zyra e Prokurimit - Kushtrim Mehaj – Zyrtar Përgjegjës i Prokurimit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim në Kërkesën për Rishqyrtim për Aktivitetin e Prokurimit “Mirëmbajtja verore e rrugëve në qytet, periferi dhe Liqenit Akumulues”, me nr. të prok: 642-25-3767-2-1-1



Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Mitrovicës Jugore në mbështetje të nenit 108/A, (paragrafi 10.1) të Ligjit Nr.05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.04/L042 për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-092, duke vendosur sipas Kërkesës për Rishqyrtim të Operatori Ekonomik: “BENI - COM SH.P.K”, të datës 07.07.2025 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Mirëmbajtja verore e rrugëve në qytet, periferi dhe Liqenit Akumulues”, me nr. të prok: 642-25-3767-2-1-1, kundër NJOFTIMIT mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues dhe Letrës standarde të datës 02.07.2025, Autoriteti Kontraktues nxjerr këtë:

V E N D I M

1. **REFUZOHET** si e pabazuar kërkesa për rishqyrtim e parashtuar me datë 07.07.2025, nga Operatori Ekonomik: “BENI - COM SH.P.K”, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Mirëmbajtja verore e rrugëve në qytet, periferi dhe Liqenit Akumulues”, me nr. të prok: 642-25-3767-2-1-1, kundër NJOFTIMIT mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues dhe Letrës standarde të datës 02.07.2025.
2. Autoriteti Kontraktues qëndron prapa Njoftimit për kontratë për Aktivitetin e Prokurimit dhe sipas LPP-ës dhe legjistacionit dytësor të Prokurimit Publik.
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nëshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

A R S Y E T I M M B I R E F U Z I M I N

Operatori Ekonomik: “BENI - COM SH.P.K”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Mirëmbajtja verore e rrugëve në qytet, periferi dhe Liqenit Akumulues”, me nr. të prok: 642-25-3767-2-1-1, kundër NJOFTIMIT mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues dhe Letrës standarde të datës 02.07.2025, ka bërë Kërkesës për Rishqyrtim me datë 07.07.2025 sipas nenit 108/A, të Ligjit Nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.04/L/237.

Pas analizimit të pretendimeve ankimore AK ka konstatuar se kërkesa për rishqyrtim është e pabazuar për këto arsye:

PRETENDIMI ANKIMOR 1):

Pretendimi i parë (I)

Autoriteti Kontraktues ofertën tonë e cilëson si të papërgjegjshme me arsyetimin se:

Inxhinierin i ofruar nga ana e juaj nuk e plotëson kushtin dhe kriterin e vendosura si në DT dhe NJK sepse është kërkuar Inxhinier ose Master i Makinerise apo Mekanikës drejtimi Mekatronikë, ndërsa ju keni prezentuar Inxhinierin e Diplomuar të Makinerisë - Drejtimi i Përgjithshëm.

Kapaciteti teknik dhe profesional: Kërkesa 7. Operatori Ekonomik duhet të ketë një Listë për paisjet-mjetet stabilimentet që ka në dispozicion për realizimin e projektit sipas Aneksit 7 (pika 1: Kamion kiper me kapacitet min 10m³ 2 copë) Ndërsa ju keni prezentuar 2 Kamion sipas pikës 1 mirëpo njëri nga ta nuk ka librezë të regjistrimit valid siç është kërkuar në DT dhe NJK. (01-159-KT) data e skadimit të regjistrimit 28.05.2025.

Këto arsyetime nuk janë të bazuara dhe nuk e pasqyrojnë realitetin dhe gjendjen faktike por si të tilla paraqesin fakte të rreme me qëllim të justifikimit të këtij vendimi i cili është në kundërshtim me parimet dhe kriteret e nenit 59, nenit 69 të LPP-së lidhur me nenin 40 paragrafi 1,2 dhe 6 të RrPP nr. 002/2024.

1. Fillimisht sa i përket arsyetimit të parë për eliminimin tonë në lidhje me inxhinierin e Makinerise drejtimi Mekatronike, ky arsyetim nuk qëndron për dëshmitë në vijim:

Kjo pasi ne kemi dorëzuar Inxhinierin e Makinerise Drejtimi i përgjithshëm pasi në vitin e diplomimit të këtij inxhinieri nuk ka ekzistuar ky drejtim dhe se të gjitha drejtimet kanë qenë të përfshira në të. Inxhinieri i paraqitur nga ana jonë zotëron përvojë konkrete në fusha që lidhen ngushtë me mekatronikën dhe ka aftësi të plota për të përmbushur kërkesat e projektit. Inxhinieri i dorëzuar nga ne i diplomuar në periudhën kur në programin përkatës akademik nuk ka ekzistuar ndarja e drejtimeve specifike, përfshirë edhe drejtimin "Mekatronikë". Në atë kohë, të gjitha nën-drejtimet teknike kanë qenë të përfshira brenda kurrikulës së përgjithshme të Inxhinierisë së Makinerisë. Bazuar në sa më sipër, konsiderojmë se është përmbushur në tërësi kërkesa e DT-së, si në aspektin arsimor, ashtu edhe në atë të përvojës profesionale, për më tepër duke pasur parasysh që drejtimi "Mekatronikë" nuk ka qenë i ndarë si specifik në vitin e diplomimit të inxhinierit.

Duke u bazuar në këtë kërkesë ne kemi dorëzuar inxhinierin e projektit me të gjitha të dhënat e kërkuara.

Pra AK ka vlerësuar padrejtësisht ofertën tonë si të papërgjegjshme me arsyetim se nuk kemi plotësuar kërkesa të cilat nuk kanë qenë pjesë e dosjes së tenderit kështu duke bërë shkelje të Nenit 52, Nenit 59.2, Nenit 59.4, Nenit 72.1, Nenit 72.2 të LPP-së si dhe Nenit 40.1 të RrPP-së. Poashtu AK ka bërë shkelje edhe të Nenit 56 të LPP-së më saktësisht të paragrafit 3 ku kemi: "Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkesë ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit."

Mirëpo AK duke pasur qëllim dhe shkas të caktuar para vetes eliminimin tonë me çdo kusht dhe arritjen e rezultatit të dëshiruar për këtë aktivitet të prokurimit, pa dhënë asnjë shpjegim dhe arsye të bazuar mbi faktet vendimtare dhe dispozitat ligjore të LPP-së shkel parimet e drejtësisë dhe arsyet njerëzore, duke abuzuar qëllimisht me detyrën zyrtare ndërmerr masa të

jashtëligjshme në kundërshtim me kërkesat procedurale dhe qenësore të legjislacionit të prokurimit me qëllim të eliminimit të parashtruesit të kërkesës për rishqyrtim dhe krijimit të rrethanave për të krijuar një rezultat.

2. Sa i përket arsytimit të dytë të eliminimit tonë lidhur me: *Kamionin me targa 01-159-KT*, ky arsyetim nuk qëndron për dëshmitë në vijim:

Kjo pasi ky mjet është i regjistruar dhe ka qenë i regjistruar mirëpo AK në këtë rast ka bërë shkelje të Nenit 72 të LPP-së më saktësisht të paragrafit 2 ku kemi: “*Autoriteti kontraktues mund të ftajë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të këtij ligji*”. E njëjta parashihet edhe tek Rregullorja nr. 002/2024 më saktësisht tek Neni 38, por një gjë të tillë nuk e ka bërë duke na diskriminuar dhe duke shkelur nenin 7 dhe nenin 59 të LPP-së, konkretisht nenin 59 par. 1 të LPP-së. Si dëshmi ne do të ngarkojmë librezën me dëshmitë të cilat i cekëm.

Dëshmi 1: Libreza për paisjen me targa 01-159-KT;

Oferta jonë është e plotë dhe e saktë me të gjithë dokumentet e saj shoqëruese në përputhje me të gjitha kriteret dhe dokumentet (dëshmitë) e tenderit të përcaktuara nga AK në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit.

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMIN I ANKIMORE NDAJ OE “BENI - COM SH.P.K”:

Pretendimi se oferta juaj u skualifikua mbi baza jashtë Dokumentacionit të Tenderit (DT) apo në kundërshtim me parimet e LPP është i pabazuar. Eliminimi i ofertës suaj si e papërgjegjshme (jo në përputhje) u bë ekskluzivisht mbi kriteret e parashtruara në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit, ashtu siç kërkohet nga neni 59.4 i LPP-së. Ky nen përcakton se Autoriteti Kontraktues e konsideron një tender të përgjegjshëm vetëm nëse ai është në pajtim me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Në rastin tuaj, Komisioni Vlerësues konstatoi mungesë përmbushjeje të dy kërkesave thelbësore të DT-së nga ana e ofertës suaj, konkretisht: (1) Kërkesa për inxhinier “Mekatronikë” dhe (2) Kërkesa për dëshmi të regjistrimit të mjetit - kamionit me targa 01-159-KT.

Sqarojmë se të dyja këto kërkesa ishin qartë të përcaktuara në dosjen e tenderit, pra nuk janë “kërkesa që nuk kanë qenë pjesë e DT-së” siç pretendohet. Për kërkesën e parë, DT-ja parashihte angazhimin e një Inxhinieri të Makinerisë - drejtimi Mekatronikë për realizimin e kontratës. Ju si GOE “BENI - COM SH.P.K dhe BAGERI SH.P.K. nuk dorëzoi diplomë apo kualifikim në drejtimin “Mekatronikë”; dokumenti i paraqitur përfaqësonte një profil tjetër (Inxhinieri e Makinerisë - drejtim i përgjithshëm). Ankesa e juaj me argumentin se në kohën e diplomimit të inxhinierit të ofruar “nuk ekzistonte ky drejtim (Mekatronikë) si i ndarë” dhe se kualifikimi i tyre mbulon këtë fushë. Megjithatë, Autoriteti Kontraktues është i detyruar t’i përmbahet formulimit të saktë të kriterit të kualifikimit ashtu siç është shpallur. Diplomimi në një profil tjetër, pa një dëshmi zyrtare të specializimit të kërkuar, përbën mospërmbushje të qartë të kërkesës kualifikuese. Rrjedhimisht, oferta juaj nuk mund të konsiderohej “e përgjegjshme” sepse nuk përputhej me një kusht esencial të DT-së, në përputhje me nenin 59.4 të LPP-së dhe nenin 40.2 të RrPP-së që ndalon ndryshimin ose heqjen e kriterëve të paracaktuara gjatë vlerësimit. Neni 56.3 i LPP-së, të cilit ju i referoheni, ndalon skualifikimin mbi baza jashtë atyre të shpallura; në këtë rast, skualifikimi u bë pikërisht mbi bazën e një kriteri të shpallur, jo mbi ndonjë kriter të paqartë apo të pa-parashtruar.

Prandaj, nuk ka shkelje të nenit 56.3 LPP apo nenit 7.6 LPP (i cili ndalon përdorimin e kërkesave të paspecifikuara gjatë vlerësimit); përkundrazi, AK veproi në përputhje të plotë me to duke refuzuar një ofertë që devijonte materialisht nga kushtet e shpallura

Sa i takon mjetit - kamionit me targa 01-159-KT, DT-ja kërkonte që operatorët ekonomikë të dëshmonin disponueshmërinë e pajisjeve kryesore (p.sh. kamionë) të regjistruara e funksionale për ekzekutimin e kontratës. Nga dokumentacioni juaj i dorëzuar figuronte dëshmia e regjistrimit të këtij mjeti i skaduar (librezë e regjistrimit nuk ishte e vlefshme). Ju pretendoni se kamioni “është dhe ka qenë i regjistruar”

dhe se AK duhej t'ju kërkonte sqarim/plotësim dokumentesh në vend se t'ju skualifikonte, duke iu referuar nenit 72 të LPP-së dhe nenit 38 të RrPP-së. Së pari, sqarojmë se mosdorëzimi i një dokumenti të kërkuar detyrimisht në DT brenda afatit të tenderimit nënkupton objektivisht mospërbushjen e atij kriteri në momentin e vlerësimit. Neni 72.1 i LPP-së lejon që, kur dokumentacioni i dorëzuar nga OE “është ose duket të jetë i paplotë ose i pasaktë, ose mungojnë dokumente specifike”, autoriteti kontraktues MUND të kërkojë nga OE që ta plotësojë apo sqarojë informacionin përkatës brenda një afati kohor të caktuar, duke respektuar parimin e trajtimit të barabartë dhe transparencës. Formulimi “mund të kërkojë” nënkupton që kjo është diskrecion (e drejtë) e autoritetit kontraktues, jo detyrim absolut. Gjithashtu, neni 72.3 i LPP-së dhe neni 38.3 i RrPP-së theksojnë që çdo dokument i pranuar pas hapjes duhet të reflektojë një gjendje ekzistuese para skadimit të afatit të dorëzimit, duhej të ekzistonte e të ishte i vlefshëm në momentin e dorëzimit të ofertave. Barrën për dorëzimin e dokumentacionit të plotë e keni ju si ofertues.

Në këtë kuptim, AK nuk kishte detyrim ligjor t'ju ftonë për plotësim të dokumentit të munguar, veçanërisht kur mungesa e tij cenonte një kriter themelor të kualifikimit (disponueshmërinë e mjetit të kërkuar). Për më tepër, trajtimi i barabartë (neni 7 LPP) na dikton që të gjithë operatorët t'u nënshtrohen të njëjtave kërkesa: disa nga konkurrentët tuaj dorëzuan dokumente regjistrimi për pajisjet e tyre sipas kërkesës; falja e mungesës së dokumentit në ofertën tuaj do t'ju vendoste në avantazh të paarsyeshëm ndaj tyre, duke shkelur parimin e barazisë në trajtim. Pra, nuk qëndron pretendimi se AK “ju diskriminoi” duke mos kërkuar sqarime shtesë; përkundrazi, AK veçoi konform ligjit dhe barazisë, duke gjykuar me të njëjtin standard secilin ofertues. Neni 59.2 LPP (i cili ju citohet) i lejon Komisionit të Vlerësimit të kërkojë sqarime për ndonjë aspekt të tenderit, por nuk e detyron kërkimin e sqarimeve kur mungon një dëshmi thelbësore kualifikuese - sidomos kur një mungesë e tillë nënkupton se kriteri nuk u përmbush në kohë. Nga sa më sipër, oferta juaj me të drejtë u cilësua e papërgjegjshme sepse nuk përmbushi plotësisht kushtet esenciale të tenderit (pra, kishte devijime jo të vogla, por thelbësore ndaj kriterëve të shpallura). Kjo është në harmoni të plotë me nenin 59.4 të LPP-së, i cili lejon vetëm devijime/minore që nuk prekin aspektet materiale të ofertës. Në rastin tuaj, devijimet (mungesa e kualifikimit specifik dhe dokumentit të regjistrimit) ishin materiale, prandaj e bënë ofertën të papërgjegjshme. Nuk ka pasur asnjë “fakt të rremë” apo qëllim diskriminues nga AK në këtë vlerësim - ky është zbatim i drejtëpërdrejtë i ligjit dhe dokumentacionit të tenderit.

Andaj, Refuzohet pretendimi i juaj si i pabazuar.

PRETENDIMI ANKIMOR 2):

AK ka bërë shkelje edhe të Nenit 59.4 të LPP-së lidhur me Nenin 40 të RrPP-së pasi ka vlerësuar ofertën e GOE EURONDERTIMI SHPK ; MILENIUM KONSTRUKSION SHPK si ofertë të përgjegjshme dhe njëkohësisht duke e rekomanduar për shpërblim me kontratë edhe pse i njëjti është i papërgjegjshëm pasi nuk plotëson kriteret e vendosura në FTD-në e këtij aktiviteti të prokurimit. AK duke vepruar në kundërshtim me nenin 61 të LPP-së dhe nenin 41 të Rregullores për Prokurim Publik e ka rekomanduar për shpërblim me kontratë një OE i cili në tërësinë e parallogarisë së tij përbën një tender jo të besueshëm - jo-normalisht të ulët për faktin se nëse krahasohet me objektin e kontratës ka dallime substanciale në raport me çmimet reale të tregut. Kësisoj dhënia e kontratës një tenderuesi me çmime jo-normalisht të ulët ka ndikim negativ në performancë të implementimit të kontratës, rrjedhimisht rrezikon cilësinë dhe ekzekutimin e kontratës. Duke qenë të bindur se ne si GOE pjesëmarrës jemi dëmtuar nga rezultati i këtij aktiviteti me supozimin se përzgjedhja e OE të rekomanduar me kontratë është bërë në kundërshtim me kërkesat ligjore që dalin nga neni 59.4, neni 60 par.1.1 dhe neni 61 i LPP-së lidhur me nenin 41 të Rregullores për Prokurim Publik. Pas analizimit të hollësishëm të dokumentacionit të siguruar nga qasja zyrtare në dosjen e tenderit të OE të rekomanduar për shpërblim me kontratë “GOE EURONDERTIMI SHPK ; MILENIUM KONSTRUKSION SHPK.”, duke analizuar edhe çmimet dhe kushtet e tregut kemi vërejtur se oferta financiare (parallogaria) në shumicën e elementeve/pozicioneve të paramasës është me çmime të cilat në mënyrë substanciale janë nën nivelin e çmimeve reale të tregut andaj në pikpamje faktike fillimisht përbën tender jo të besueshëm dhe me çmime manipulative i cili ka për qëllim të shtrembërojë konkurrencën e drejtë të OE ankues dhe tenderuesve pjesëmarrës, ofertimet e të cilëve janë në pajtueshmëri

me çmimet dhe kushtet e tregut dhe konkurrencës. Ndërsa në pikëpamje juridike bazuar në kërkesat ligjore nga neni 61 i LPP-së dhe neni 41 të Rregullores për Prokurim Publik, i njëjti përbën tender me çmime jo-normalisht të ulët dhe njëkohësisht rrezikon cilësinë dhe ekzekutimin e kontratës. Andaj si i tillë në kuptim faktik e juridik ky tender do të duhej që të refuzohej si tender jo-normalisht i ulët, rrjedhimisht tender i papërgjegjshëm. Disa nga pozicionet që ky OE ka ofruar çmime manipuluese janë: 1.6 1.11 1.13 2.1 2.2 2.3 3.1 3.2 3.3 (abnormalisht i lartë) 3.6 3.7 3.8 3.9 4.1 4.2 5.1 5.2 5.3 5.5 Pra për të gjitha këto pozicione ky GOE ka paraqitur çmime abnormalisht të ulëta ndërsa tek pozicioni 3.3 i cili ka qenë: Furnizimi, lakimi, shtrirja, lidhja e armaturës S500H ka vendosur çmim abnormalisht të lartë prej 6.00€/kg kur dihet se çmimi i tregut varion prej 0.70€ deri më 1.5€. Pra me një fjalë ky GOE ka paraqitur çmime manipuluese dhe në këtë rast do duhej të refuzohej oferta e tij pas sqarimit të pranuar nga ana e AK-së.

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMIN 2 ANKIMORE NDAJ OE “BENI - COM SH.P.K”:

Ju pretendoni se AK ka gabuar duke e vlerësuar këtë ofertë si të përgjegjshme dhe se ajo duhej refuzuar si “jo-normalisht e ulët” dhe/ose për mungesë të kriterieve teknike. Këto pohime nuk qëndrojnë, siç argumentohet më poshtë:

Përmbushja e kriterëve të tenderit: Konsorciumi EURONDERTIMI & MILENIUM i ka plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit. Gjatë fazës së shqyrtimit të kualifikimit dhe vlerësimit teknik, Komisioni Vlerësues verifikoi se dokumentet dhe dëshmitë e paraqitura nga ky operator ishin në rregull dhe në përputhje me kriteret e përcaktuara. Pretendimi juaj se ky operator “nuk plotëson kriteret e vendosura në FTD” nuk shoqërohet me asnjë provë konkrete në kërkesën tuaj - ju nuk keni specifikuar se cili kriter mungon apo është shkelur prej tyre. Nga analiza jonë, konsorciumi i rekomanduar për kontratë i është përgjigjur saktë çdo kërkesë (p.sh., për përvojën, stafin profesional, pajisjet, certifikatat apo kriteret e tjera të përshtatshëmrisë). Prandaj, AK me të drejtë e cilësoi ofertën e tyre “të përgjegjshme” në kuptim të neni 59.4 të LPP-së, pasi ishte në pajtim me të gjitha kërkesat e njoftimit dhe DT-së. Nuk ka pasur asnjë devijim material që do ta bënte atë ofertë të papërgjegjshme. Në këtë drejtim, neni 40.2 i RrPP-së rikonfirmon se tenderët e pranuar në kohë do të vlerësohen sipas procedurave e kriterëve të shpallura, dhe nuk lejohet heqja apo ndryshimi i këtyre kriterëve gjatë vlerësimit. AK ka zbatuar pikërisht këtë parim, duke mos shpërfillur asnjë kriter për operatorin fitues; përkundrazi, ai u konstatua me meritë se i plotësonte të gjitha.

Çështja e tenderit “jo-normalisht të ulët”: Ligji dhe Rregullorja parashtrojnë procedurë specifike kur haset një tender me çmim jo-normalisht të ulët. Neni 61 i LPP-së përcakton se, nëse një tender duket jo-normalisht i ulët, AK duhet t’i dërgojë kërkesë me shkrim tenderuesit për sqarime të elementeve përbërëse dhe bazës së atij çmimi. Pas marrjes së shpjegimeve me shkrim, AK vlerëson arsyetimet e tenderuesit në lidhje me faktorët relevantë (p.sh. ekonominë e metodave, zgjidhjet teknike, kushte posaçërisht të favorshme, etj.). Vetëm nëse, pas shqyrtimit të këtyre informacioneve, AK konstaton se tenderi është realisht jo-normalisht i ulët për shkaqe të pajustificuara, atëherë e refuzon atë. Në rast se shpjegimet janë të mjaftueshme, ligji detyron që tenderi të trajtohet njësoj si të tjerët, pra të mos refuzohet thjesht pse çmimi është i ulët.

Në përputhje me këtë procedurë ligjore për këtë arsye, Komisioni kërkoi shpjegime shtesë nga EURONDERTIMI & MILENIUM lidhur me komponentët e çmimit të ofruar. Ky operator ekonomik dorëzoi një sqarim me shkrim, duke argumentuar ndër të tjera se:

- Një pjesë e madhe e pajisjeve dhe mekanizimit të nevojshëm ata e disponojnë vetë (çka ul ndjeshëm koston e ofruar);
- Kanë kosto operative më të ulëta falë eficiencës së brendshme dhe burimeve të veta (p.sh. bazë materiale, staf me përvojë që redukton koston e punës për njësi);
- Çmimet e disa pozicioneve i kanë llogaritur më ulët duke aplikuar metoda më ekonomike pune dhe furnizimi, si dhe duke synuar një fitim minimal, me qëllim rritjen e portofolit të kontratave të tyre (strategji komerciale e lejuar).

Komisioni, së bashku me Zyrën e Prokurimit, i vlerësoi këto shpjegime të faktorëve të parashikuar në nenin 61.2 të LPP-së. U konstatua se çmimi jashtëzakonisht i ulët ishte i justifikuar nga arsyet objektive të parashtruara prej operatorit. Me fjalë të tjera, oferta e tyre ishte e qëndrueshme pavarësisht nivelit të ulët të çmimit, pasi mbështetej në avantazhe konkrete (kapacitete ekzistuese, etj.). Në bazë të neni 61.3 të LPP-së, kur shpjegimi i tenderuesit konsiderohet i mjaftueshëm, AK duhet ta trajtojë tenderin si normal,

pra ta pranojë atë. Kjo është pikërisht çfarë bëri AK në këtë rast. Duhet theksuar se ligji nuk parashikon refuzim “automatik” të një oferte vetëm sepse çmimi është shumë i ulët; përkundrazi, kërkohet një proces verifikimi dhe një vendim i arsyetuar. AK, duke mos e refuzuar ofertën e konsorciumit fitues, ka zbatuar me përpikmëri nenin 61 të LPP-së dhe nenin 41 të RrPP-së (i cili detajon trajtimin e tenderëve jonormalisht të ulët, duke kërkuar nga autoritetet hetim të kujdesshëm dhe jo përjashtim arbitrar).

Për sa i përket “rrezikut të cilësisë dhe ekzekutimit”, kuptojmë shqetësimin teorik që një çmim anormalisht i ulët mund të cenojë cilësinë e realizimit. Por këto janë spekulime të përgjithshme. Ligji vetë e ka balancuar këtë rrezik me mekanizmin e mësipërm të verifikimit dhe, gjithashtu, me mjete kontraktuale si siguria e ekzekutimit dhe klauzolat e penaliteteve në kontratë (të cilat aplikohen nëse operatori dështon të kryejë punimet si duhet). Në këtë tender, sipas DT-së, është parashikuar vendosja e sigurimit të ekzekutimit 10% të vlerës së kontratës për fituesin, si dhe aplikimi i penaliteteve në rast vonese apo mos-përbushjeje, konform nenit 71A të Rregullores (Penaliteteve). Këto masa e mbrojnë Autoritetin Kontraktues nga abuzimi apo mosrealizimi eventual i kontratës. Për më tepër, performanca e operatorit do të monitorohet rreptësisht nga Menaxheri i Kontratës, çdo devijim nga specifikimet do të sanksionohet. Pra, AK ka vlerësuar se oferta e përmendur ishte ekonomikisht e leverdishme dhe e realizueshme. Nuk është detyrë e AK-së të paragjykojë se një operator “nuk do ta përbushë kontratën” pa prova - përndryshe do të diskriminonim pa bazë juridike ofertuesin me çmim të ulët, gjë që do shkelte parimin e trajtimit të barabartë. Neni 7 i LPP-së ndalon qartë diskriminimin e operatorëve ekonomikë dhe imponon transparencë; refuzimi i pajustificuar i ofertës më të lirë do të ishte në kundërshtim me këto parime po aq sa do të ishte dëm ekonomik për fondet publike.

Andaj, Refuzohet pretendimi i juaj si i pabazuar.

PRETENDIMI ANKIMOR 3):

AK ka bërë shkelje edhe të Nenit 59.4 të LPP-së lidhur me Nenin 40 të RrPP-së pasi ka vlerësuar ofertën e GOE VALDRINI SHPK; FSC ING SHPK; IBRAHIM KURRUMELI B.I. si ofertë të përgjegjshme edhe pse i njëjti është i papërgjegjshëm pasi nuk plotëson kriteret e vendosura në FTD-në e këtij aktiviteti të prokurimit.

AK duke vepruar në kundërshtim me nenin 61 të LPP-së dhe nenin 41 të Rregullores për Prokurim Publik e ka vlerësuar si të përgjegjshëm një OE i cili në tërësinë e parallogarisë së tij përbën një tender jo të besueshëm - jo-normalisht të ulët për faktin se nëse krahasohet me objektin e kontratës ka dallime substanciale në raport me çmimet reale të tregut. Kështu që dhënia e kontratës një tenderuesi me çmime jo-normalisht të ulët ka ndikim negativ në performancë të implementimit të kontratës, rrjedhimisht rrezikon cilësinë dhe ekzekutimin e kontratës. Duke qenë të bindur se ne si GOE pjesëmarrës jemi dëmtuar nga rezultati i këtij aktiviteti me supozimin se përzgjedhja e OE të përgjegjshëm është bërë në kundërshtim me kërkesat ligjore që dalin nga neni 59.4, neni 60 par.1.1 dhe neni 61 i LPP-së lidhur me nenin 41 të Rregullores për Prokurim Publik. Pas analizimit të hollësishëm të dokumentacionit të siguruar nga qasja zyrtare në dosjen e tenderit të OE të rekomanduar për shpërblim me kontratë “GOE VALDRINI SHPK; FSC ING SHPK; IBRAHIM KURRUMELI B.I.”, duke analizuar edhe çmimet dhe kushtet e tregut kemi vërejtur se oferta financiare (parallogaria) në shumicën e elementeve/pozicioneve të paramasës është me çmime të cilat në mënyrë substanciale janë nën nivelin e çmimeve reale të tregut andaj në pikpamje faktike fillimisht përbën tender jo të besueshëm dhe me çmime manipulative i cili ka për qëllim të shtrembërojë konkurrencën e drejtë të OE ankues dhe tenderuesve pjesëmarrës, ofertimet e të cilëve janë në pajtueshmëri me çmimet dhe kushtet e tregut dhe konkurrencës. Ndërsa në pikëpamje juridike bazuar në kërkesat ligjore nga neni 61 i LPP-së dhe nenit 41 të Rregullores për Prokurim Publik, i njëjti përbën tender me çmime jo-normalisht të ulët dhe njëkohësisht rrezikon cilësinë dhe ekzekutimin e kontratës. Andaj si i tillë në kuptim faktik e juridik ky tender do të duhej që të refuzohej si tender jo-normalisht i ulët, rrjedhimisht tender i papërgjegjshëm. Disa nga pozicionet që ky OE ka ofruar çmime manipuluese janë: 1.13 2.1 2.2 2.3 4.1 Pra për të gjitha këto pozicione ky GOE ka paraqitur çmime abnormalisht të ulëta. Sa i përket eliminimit të Operatorëve tjerë pjesëmarrës në këtë rast pajtohemi me vendimin e AK-së se të njëjtit janë të papërgjegjshëm dhe se të njëjtit nuk mund të klasifikohen si palë me interes material në kuptim të nenit 4.1.26 të LPP-së

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMIN 3 ANKIMORE NDAJ OE “BENI - COM SH.P.K”:

Edhe ky pretendim është i pabazuar, dhe sqarimet juridike janë pothuaj identike me ato të dhëna tek Pretendimi II, për arsye se ankesa e juaj është e të njëjtit lloj kundërshtimi - trajtimin e ofertës së një operatori tjetër si të pranueshme ndonëse ai sipas tij duhej skualifikuar si “i papërgjegjshëm” dhe/ose “jo-normalisht i ulët”.

Si parim, çdo ofertë me çmim të ulët trajtohet njësoj siç u përshkrua në Pretendimin II: neni 61 LPP kërkon marrjen e shpjegimeve me shkrim nga operatori për të kuptuar arsyet e kostos së ulët, dhe vetëm nëse shpjegimet nuk janë të mjaftueshme, lejohet refuzimi. Në këtë rast, ndonëse konsorciumi “VALDRINI SHPK; FSC ING SHPK; IBRAHIM KURRUMELI B.I.” nuk u shpall fitues (oferta e tyre ishte e dyta në renditjen e çmimeve), oferta e tyre u konsiderua e pranueshme dhe e përgjegjshme, pra nuk u refuzua nga AK për shkak të çmimit të ulët. Gjithsesi, po të kishte qenë e nevojshme, AK do të zbatonte të njëjtën procedurë të nenit 61 LPP edhe për këtë konsorcium. Parimi është i pandryshuar: nuk refuzohet një ofertë me çmim të ulët pa e verifikuar dhe pa një bazë ligjore.

Ju si OE ankues po pretendoni se Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontratë “duhej skualifikuar” nuk kanë ndikim tek rezultati final - megjithatë ne kemi detyrimin t’ju sqarojmë se as në këtë rast AK nuk ka bërë shkelje. Të gjithë operatorët e kualifikuar u trajtuan në mënyrë të barabartë, siç e kërkon neni 7.1 LPP. Në fund, kontrata iu propozua ofertuesit me çmimin më të ulët ndër ofertat e përgjegjshme, dhe konsorciumi “VALDRINI SHPK; FSC ING SHPK; IBRAHIM KURRUMELI B.I.” u rendit si konkurrent i pasuksesshëm.

Andaj, Refuzohet pretendimi i juaj si i pabazuar.

PRETENDIMI ANKIMOR 4):

Komisioni i vlerësimit ka bërë shkelje të Nenit 59.1 të LPP-së dhe Nenit 40.1 të RRPP-së pasi të njëjtit janë të obliguar që të vlerësojë dhe krahasojë tenderët e përgjegjshëm sipas kriterëve për dhënien e kontratës të përcaktuara në njoftimin e kontratës / dosjen e tenderit, gjithnjë sipas Nenit 40.13 të RRPP-së.

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMIN 4 ANKIMORE NDAJ OE “BENI - COM SH.P.K”:

Ky pretendim ngre një çështje parimore: A i ka vlerësuar Komisioni i Vlerësimit tenderët në pajtim me kriterin e shpallur të dhënies së kontratës? Ju sugjeroni se Komisioni nuk e ka bërë këtë, duke përmendur nenin 59.1 të LPP-së dhe 40.1 të RrPP-së (që kërkojnë vlerësim e krahasim të tenderëve të përgjegjshëm) dhe nenin 40.13 të RrPP-së (që specifikon po ashtu vlerësimin krahasues vetëm mes tenderëve të përgjegjshëm sipas kriterit të dhënies).

Sqarojmë se: Komisioni i Vlerësimit e ka kryer detyrën e vet në mënyrë të plotë, objektive dhe në përputhje me këto dispozita. Në kuadër të këtij aktiviteti prokurimi, kriteri për dhënie të kontratës ishte “Tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët”. Kjo do të thotë, siç edhe e theksoni, se vetëm pasi të identifikohen tenderët e përgjegjshëm (pra që plotësojnë kushtet e tenderit), krahasohen ofertat e tyre financiare dhe kontrata i jepet atij me çmimin më të ulët.

Në përmbledhje, Komisioni i vlerësimit i AK-së KA vlerësuar dhe krahasuar tenderët e përgjegjshëm sipas kriterëve të dhënies. Çdo sugjerim i kundërt bazohet në keqkuptimin se pse oferta juaj nuk u krahasua në çmim me ofertën fituese. Sqarimi ligjor është i thjeshtë: oferta juaj u eliminua me të drejtë si e papërgjegjshme, pra nuk kualifikohej për fazën e krahasimit të çmimeve. Ky veprim është i mbështetur plotësisht në nenin 7.6 LPP, i cili imponon që “tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtësore të kushteve, kriterëve dhe specifikimeve”- domethënë, vetëm ofertat që i përmbushin të gjitha këto aspekte mund të zgjidhen fituese. Pikërisht këtë parim ka ndjekur Komisioni: ka krahasuar vetëm ato oferta që i përmbushnin kushtet (pra, ofertat e konsorciumeve të kualifikuara), dhe ka propozuar fitues ofertën me çmimin më të ulët ndër to. Nuk ka pasur asnjë anashkalim apo shkelje procedure

Andaj, Refuzohet pretendimi i juaj si i pabazuar.

PRETENDIMI ANKIMOR 5):

AK ka bërë Shkelje të rëndë (Neni 97.1.o të RRPP-së) pasi me provat e mësipërme dëshmohet se kemi të bëjmë me sjellje të gabuar dhe jo profesionale të zyrtarit përgjegjës të prokurimit ndaj kompanisë sonë. Kjo pasi i njëjti është i obliguar sipas Nenit 39.4 të RrPP-së të organizoj punën e komisionit vlerësues dhe do të siguroj respektimin e dispozitave të LPP. AK-ja nuk e ka respektuar edhe nenin 7 të LPP-së, ku edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë nuk jemi rekomanduar për kontratë. Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që “Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente. Po ashtu paragrafi 6 i nenit 7 të LPP-së e parasheh që Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të siguroj: që (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtësore të kushteve, kriterëve dhe specifikimeve përkatëse”, mirëpo AK-ja nuk i është përmbajtur as kësaj dispozite ligjore. Po ashtu autoriteti kontraktues nuk e ka pasur në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë. Prandaj, faktet dhe rrethanat e lartcekura e vërtetojnë se vendimi i AK-së është i kundërligjshëm, sepse gjatë procedurës së vlerësimit është vendosur në dëm të tenderit/ofertës së OE ankues duke na mohuar të drejtën e ligjshme të shpërblimit me kontratë, pavarësisht faktit se kemi paraqitur tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët. Andaj duke konsideruar se AK ka vepruar në kundërshtim me aplikimin e dispozitave të lartëshënuara të LPP-së dhe akteve nënligjore, ku si pasojë e shkeljeve ka rezultuar me dëmtimin e marrjes së kontratës nga OE BENI – COM SH.P.K. pasi jemi ofertues i përgjegjshëm dhe plotësojmë të gjitha kriteret e vendosura në FTD-në e këtij aktivitetit të prokurimit, kërkojmë nga AK të marrë në konsideratë dhe të vlerësojë të gjitha faktet e paraqitura në këtë kërkesë për rishqyrtim dhe duke u udhëhequr nga parimi i ligjshmërisë, barazisë dhe mosdiskriminimit, pavarësisht dhe paanësisht në vendimmarrje.

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMIN 5 ANKIMORE NDAJ OE “BENI - COM SH.P.K”:

Gjatë gjithë procesit të vlerësimit, AK - përfshirë këtu Zyrtarin e Prokurimit, Komisionin Vlerësues dhe stafin tjetër mbështetës - kanë vepruar me profesionalizëm të plotë, pa asnjë anim apo qëllim tendencioz. Rregullorja e Prokurimit Publik (neni 39.4) ju referohet detyrave të Zyrtarit të Prokurimit për të organizuar komisionin vlerësues dhe për t’u siguruar se dispozitat e LPP-së respektohen gjatë procesit. Kjo detyrë është përmbushur në tërësi, komisioni është konstituar me njerëz kompetentë, të pavarur dhe është udhëzuar të ndjekë me përpikmëri ligjin dhe kriteret e tenderit. Rezultati i vlerësimit - i cili, për hir të transparencës, ju është komunikuar me shkrim - është produkt i zbatimit rigoroz të LPP-së dhe RrPP-së, gjë që e kemi demonstruar detajisht më sipër (duke adresuar secilin pretendim tuajin). Vetëm fakti që ky rezultat nuk ju favorizon ju si operator (sepse oferta juaj rezultoi e papërgjegjshme dhe me çmimin më të lartë ndër pjesëmarrësit) nuk mund të shërbejë si provë e “mosrespektimit të parimeve” apo e ndonjë keqveprimi nga ana e AK-së.

Lidhur me nenin 97, paragrafi 1, pika (o) të RrPP-së, nga sa kuptojmë, ju pretendoni se veprimet apo mosveprimet e AK-së në këtë tender paraqesin një nga shkeljet e rënda të parapara në atë nen (pika “o” zakonisht lidhet me shkelje të parimeve bazë, shpërdorim të detyrës apo veprime korruptive).

Kjo akuzë është krejtësisht e pabazuar dhe e papranueshme. Nuk ka asnjë provë që ndonjë nga personat zyrtarë të përfshirë në proces ka shkelur ligjin me dashje apo nga pakujdesia e rëndë. Përkundrazi, siç kemi argumentuar, vendimi i AK-së është tërësisht i ligjshëm dhe i arsyetuar mbi bazën e kriterëve të tenderit dhe dispozitave pozitive. Po të ekzistonte ndonjë shkelje e tillë e rëndë, vetë AK do ta adresonte; në mungesë absolute të saj, pretendimi juaj mbetet një pohim i pambështetur.

Në vijim, ju riktheheni te neni 7 i LPP-së, duke thënë se AK nuk e paska respektuar, me arsyetimin se ju “i keni plotësuar të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit” por prapë nuk u shpallët fitues. Këtu duhet të jemi shumë të qartë: Pretendimi se “i keni plotësuar të gjitha kërkesat” është i gabuar. Siç u argumentua te Pretendimi I, ju nuk i plotësuat të gjitha kërkesat e tenderit (më konkretisht dështuat në dy kriteret thelbësore të kualifikimit teknik). Ky është fakt i provuar: evidencat e dosjes suaj flasin vetë (mungesa e diplomës së kërkuar të inxhinierit Mekatronikë dhe mungesa e dëshmisë së regjistrimit të mjetit kryesor).

Prandaj, nuk mund të thuhet se AK ju mohoi padrejtësisht “të drejtën e ligjshme për kontratë” - e vërteta është se oferta juaj nuk e fitoi kurrë të drejtën për t’u marrë në konsideratë për kontratë, meqë nuk u kualifikua si ofertë e përgjegjshme. Parimi i trajtimit të barabartë (neni 7.1 LPP) nënkupton që të gjithë operatorët t’u nënshtrohen të njëjtave rregulla: pikërisht kjo ka ndodhur këtu. Çdo ofertues që nuk ka plotësuar kriteret (qoftë OE “BENI - COM”, qoftë operatorët e tjerë të eliminuar) janë trajtuar njësoj - janë skualifikuar. Nga ana tjetër, operatorët që i plotësuan kriteret (dy konsorciumet e sipërpërmendura) janë trajtuar njësoj - janë vlerësuar në garë deri në fund. Nuk ka pasur as favorizim as diskriminim: secili mori rezultatin që korrespondon me përmbushjen e kriterëve dhe me çmimin e ofruar. Ky është vetë kuptimi i nenit 7.1 LPP dhe ai është respektuar plotësisht nga AK.

Gjithashtu, neni 7.6 LPP - të cilin ju me të drejtë e citoni - kërkon që tenderi i zgjedhur (fitues) të jetë në përputhje me të gjitha kushtet, kriteret dhe specifikimet përkatëse. AK pikërisht këtë ka bërë: tenderi i zgjedhur fitues (konsorciumi EURONDERTIMI & MILENIUM) është plotësisht në përputhje me kushtet, kriteret dhe specifikimet e tenderit, gjë të cilën ju nuk e kundërshtoni dot me asnjë provë. Në të kundërt, do të ishte shkelje e parimit nëse AK do të zgjidhte një tender që NUK i plotësonte të gjitha kushtet - p.sh. nëse do t’ju shpallte ju fitues ndërkohë që oferta juaj kishte mangësi. Kjo do të ishte padrejtësi dhe shkelje e ligjit. Pra, AK e ka zbatuar nenin 7.6 duke MOS zgjedhur një tender të papërgjegjshëm, por atë që ishte realisht i përgjegjshëm. Ky veprim i AK-së nuk është në kundërshtim, por në harmoni të plotë me parimin e ligjshmërisë.

Për sa i përket akuzimit se “vendimi i AK-së është i kundërligjshëm” dhe se juve ju është mohuar “e drejta ligjore” për kontratë, ju lutem kini parasysh se “e drejta” për t’u shpërblyer me kontratë lind vetëm nëse plotësohen kushtet ligjore. Nuk ekziston e drejtë e operatorit ekonomik për t’u shpallur fitues thjesht pse ka marrë pjesë në tender. E drejta për kontratë varet nga fakti nëse ai operator i ka përmbushur të gjitha kriteret dhe nëse oferta e tij rezulton më e favorshme sipas kriterëve të dhënies. Në rastin tuaj, për fat të keq, këto kushte nuk u plotësuan: (1) oferta juaj u skualifikua - pra nuk përmbushi kriteret, dhe (2) edhe sikur të mos ishte skualifikuar, çmimi juaj ishte dukshëm më i lartë se i operatorit fitues, gjë që do t’ju rendiste gjithsesi jo fitues. AK nuk ka vendosur “në dëm” tuajin, AK thjesht ka zbatuar kriteret e tenderit dhe ligjin, gjë që për ju rezultoi në një situatë të pafavorshme, por të drejtë. Kjo nuk përbën dënim apo padrejtësi, por është pjesë e konkurrencës së hapur dhe të ligjshme ku fiton oferta që i përmbush kushtet me rezultatin më të mirë (në këtë rast, me çmimin më të ulët).

Së fundi, vlen të theksohet se Autoriteti Kontraktues ka qenë tërësisht transparent në këtë proces. Të gjitha vendimet (eliminimet, kualifikimet, rekomandimi për kontratë) janë komunikuar në mënyrë të argumentuar. Ju keni ushtruar të drejtën tuaj për qasje në dokumente pas vlerësimit, dhe ne ju kemi vënë në dispozicion dosjen e tenderit për verifikim. Ky është një tregues tjetër i respektimit të parimit të transparencës (po ashtu i përfshirë në nenin 7 të LPP-së). Asgjë nuk është fshehur dhe as manipuluar - procesi është i dokumentuar dhe i auditueshëm nga çdo organ kompetent. Kjo e vërtetë objektive rrëzon çdo supozim për sjellje të parregullt apo joligjore nga ana e AK-së.

Nuk ka asnjë shkelje të rëndë apo të lehtë nga ana e AK-së, nuk ka asnjë cenim të parimeve të prokurimit publik. Përkundrazi, vendimi i AK-së është plotësisht i ligjshëm, i drejtë dhe i mbështetur në prova. AK i trajtoi të gjithë operatorët pa diskriminim dhe me transparencë (në përputhje me nenin 7.1 LPP), dhe zgjodhi si fitues tenderin që plotësonte të gjitha kushtet (në përputhje me nenin 7.6 LPP). Nuk ekziston asnjë “e drejtë e ligjshme e mohuar” për ju, sepse pjesëmarrja në tender nuk ju garanton fitimin pa plotësuar kushtet më mirë se konkurrentët. Të gjitha faktet dhe rrethanat e trajtuara më lart tregojnë qartë se pretendimet tuaja janë të pabazuara, ndërsa veprimet e AK-së janë në përputhje me LPP-në dhe RrPP-në. Për pasojë, Pretendimi V dhe akuzat brenda tij hidhen poshtë si të pabazuara dhe jofaktike.

Në përfundim, pasi u analizuan në detaj të gjitha pretendimet e parashtruara në Kërkesën tuaj për Rishqyrtim, Autoriteti Kontraktues konstaton se asnjëri prej tyre nuk qëndron mbi bazë ligjore a faktike. Procesi i prokurimit është zhvilluar konform Ligjit për Prokurimin Publik dhe Rregullores së zbatimit të tij, duke respektuar parimet e ligjshmërisë, transparencës dhe trajtimit të barabartë për të gjithë operatorët ekonomikë. Vendimi i Autoritetit Kontraktues për eliminimin e GOE “BENI COM SHPK; BAGERI

SH.P.K.” nga gara dhe për rekomandimin për kontratë të GOE “EURONDERTIMI & MILENIUM” është marrë me korrektësi të plotë ligjore dhe mbetet i qëndrueshëm.

Andaj, Refuzohet pretendimi i juaj si i pabazuar.

Bazuar në të dhënat e lartëcekura Autoriteti Kontraktues vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr.04/L042 për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-092, si dhe Legjislacionit sekondar të LPP-së.